



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçane
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës neni 5 pika c, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës neni 35, Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës neni 8, Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpallë këtë :

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS NË KOHË CAKTUAR

Shkolla e Muzikës

Një mësimdhënës për lëndën e Flautës, 10 orë mësimore
Kohëzgjatja e kontratës është në kohë të caktuara, deri më 31.12.2016.

Kushtet e konkursit :

Kualifikimi për mësimdhënës : kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativet të MASHT-it në fuqi. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it,, nr. 8/2010,në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Për vendet e punës në fjalë nevojiten këto dokumente: diploma mbi përgatitjen profesionale, kopja e letërnjoftimit, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, si dhe vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit .

Për këto vende të punës, kandidatët do t'i nënshtrohen intervistës me gojë.

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe në pajtim me normativet në fuqi.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuarat të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjiçan.

Për vendin dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen përmes shpalljes së njoftimit e cila do të vendoset në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në web faqen e Komunës, pas mbylljes së konkursit.

**Drejtori
Nazmi Musa**